



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 56
Prishtinë, më 27.08.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.06.2012;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim;**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua me disa ndryshime.

Kryetari propozoi shtimin e një pike në rendit e ditës për gjendjen e zjarreve që ka përfshirë territorin e Kosovës, gjithashtu kërkoi që për shkak të mos prezencës së z. Goran Marinkovič, pikën e tretë të rendit të ditës për Shqyrtimin dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim të lejme në fund për shkak të harmonizimit të nenit 9 për përdorimin e gjuhëve në formular. Pas përfundimit të takimit në Komisionin për minoritete, do të sjellin vendimin e këtij Komisioni dhe më pas të kemi një vendim të përbashkët për paraqitjen në seancën e radhës.

Rexhep Selimi- Propozoi një pauzë të shkurtër në mënyrë që i pranishëm në mbledhje të jetë edhe anëtari i Komisionit z.Rasim Demiri i cili ka një raportim për terrenet e përfshira nga zjarret.

Kryetari i Komisionit- Propozoi të vazhdohet me disa njoftime për anëtarët e Komisionit dhe me miratimin e Procesverbalit dhe pastaj të vazhdohet me pikat e tjera të rendit të ditës.

Fatmir Xhelili- Për pikën e tretë të rendit të ditës, tha se Raporti për Projektligjin për letërnjoftimin ka kaluar dhe është paraqitur në seancë, pasi nenin 4.2, që ka të bëjë gjuhën që duhet përdorur për personalizimin e letërnjoftimit dhe për këtë arsye është lajmëruar Komisionin për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe është rënë dakord që letërnjoftimi bëhet vetëm në gjuhët sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Tutje ai tha se nuk e kupton kush e ka kthyer si propozim nenin 9.2, i cili me vendim të Komisionit është hequr dhe në seancë është propozuar dhe se për këtë gjë është rënë dakord gojarisht me grupin 6 + dhe grupet e tjera për miratimin e tij.

Kryetari i Komisionit- Për ndryshimin në ligjin për letërnjoftime tha se kemi votuar në Komision por jo në seancë dhe se në konsultim me Kryetarin e Komisionit për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe grupin 6+ është rënë dakord që pika 9.1 e projektligjit të mbetet ndërsa 9.2 të hiqet, ndërsa në mbledhjen e sotme do të merret vendim që ta bëjmë me procedurë të rregullt dhe se në seancën e kaluar nuk ka qenë në rend të ditës, gjithashtu për çështjen në fjalë tha se në seancën e radhës do të jetë deklarimi i Grupit 6+.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.06.2012;

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 21.06.2012, i cili u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim;

Kryetari i Komisionit- Për këtë pikë tha se është rënë dakord që neni 9.2 i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-099 për letërnjoftim të fshihet, ndërsa neni 9.1 i këtij projektligji mbetet siç është në projektligj dhe kjo në pajtim me Grupin parlamentar 6+ si dhe aprovimin e Komisionit për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Tutje informoi anëtarët e Komisionit se me datën 28 gusht në Ministrinë e FSK-së mbahet ceremonia për përcjelljen e Gjeneralit të KFOR-t z.Erhard Drews, gjithashtu njoftoi për vizitën e ish- Komisionerit për forcat e armatosura të Gjermanisë z. Reinhold Robbe me të cilin është diskutuar për ngritjen e institucionit të Komisionerit për Forcat e Sigurisë së Kosovës, me të cilin është rënë dakord që në muajin shtator të themelohet grupi punues për hartimin e ligjit për Komisionerin ndërsa në muajin nëntor grupi punues të vazhdoj me një punëtori. Gjithashtu theksoi se grupi në përbërje duhet të ketë krahas anëtarëve të Komisionit edhe përfaqësues nga Ministria e FSK-së, FSK-ja dhe nga organizatat që mund të kontribuojnë aspektit të sigurisë.

Rexhep Selimi- Për çështjen e Komisionerit ai tha se gjithashtu është takuar me z. Robbe dhe se e mbështet idenë e krijimit të këtij institucioni. Tutje ai tha se dilema për një institucion të tillë ka të bëjë me faktin nëse ky institucion të përfshin sektorin e mbrojtjes apo të përfshijë edhe institucione të tjera të sigurisë siç është Policia e Kosovës, për të cilën çështje duhet një dakordim i Komisionit duke marrë parasysh numrin e vogël të tyre, ndërsa për përfshirjen sektorit të inteligjencës në këtë institucion, ai tha se duke qenë se kjo fushë nuk mbulohet nga Komisioni mund edhe të mos përfshihet kjo sferë, gjithashtu falënderoi gatishmërinë e z. Robbe për përkrahjen si dhe shprehi gatishmërinë për të kontribuar në grupin punues për këtë çështje.

Fatmir Xhelili- Për çështjen e Komisionerit për Kosovën ai tha se ka pasur takim me z. Robbe si dhe gjatë këtij takimi ka shtruar çështjet se në kuadër të këtij institucioni të përfshihet edhe Policia e Kosovës si dhe sektori i inteligjencës, në mënyrë që fusha që mbulon Komisioneri i ardhshëm të jetë fusha e të drejtave të njeriut.

Duke qenë se për institucionin në fjalë nuk kemi eksperiencë, ai propozoj krijimin e një grupi punues i cili do të vlerësoj domosdoshmërinë e krijimit të këtij institucioni, pasi të gjithë anëtarët e Komisionit pajtohen që Komisioneri të mbuloj FSK-së, të shqyrtohet mundësia që në kuadër të tij të përfshihet edhe policia dhe segmentet e tjera të sigurisë. Tutje shtoi se është e rëndësishme që gjatë fazës së hartimit të ligjit të konsultohen një grup në përbërje me anëtarët e Komisionit dhe ekspert për të konstatuar nëse ky institucion mund të mbuloj edhe policinë dhe sektorët e tjerë të sigurisë dhe mbështet idenë e një institucioni të tillë që do të mbulonte këta sektor.

Rexhep Selimi- Për institucionin e Komisionerit dhe përfshirjen në të edhe të sektorit të inteligjencës ai tha se bazuar në fushat që mbulon Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së duhet të mbulohen edhe nga Komisioneri i ardhshëm, por nëse një gjë e tillë është e mundur që në të përfshihet edhe sektori i inteligjencës e mbështet këtë ide.

Fatmir Xhelili- Ideja e krijimit të institucionit që do të mbuloj sektorin e sigurisë ai tha se nuk ka të bëjë me ndarjen e sferave që mbulojnë Komisionet përkatëse të sigurisë, por përfshirja e një segmenti në kuadër të këtij institucioni dhe se bashkëpunimi mund të bëhet me të dy Komisionet që mbulojnë sferën e sigurisë, Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe Komisionit për mbikëqyrje të AKI-së.

Kryetari i Komisionit- Për çështjen e Komisionerit të sigurisë ai propozoi krijimin e një grupi punues që do të merret me hulumtimin e përvojave të vendeve të tjera që kanë një institucion që përfshinë të gjitha segmentet e sigurisë. Modele të Komisionerit të cilat janë prezantuar nga z. Robe janë, modeli gjerman, boshnjak dhe argjentinan.

Tutje njoftoi se për këtë çështje është takuar edhe me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi, i cili e ka përkrahur mundësinë e krijimit të këtij institucioni dhe se nga ky takim mund të propozojmë krijimin e grupit punues për Komisionerin.

Rexhep Selimi- Nga takimet me z. Robbe ai tha se është diskutuar edhe për mundësinë e përfshirjes së policisë në kuadër të Komisionerit, përveç FSK-së, dhe se kjo ide është mbështetur, duke ditur numrin e vogël të forcave të sigurisë dhe se përfshirja e policisë në kuadër të Komisionerit nuk paraqet pengese.

Kryetari i Komisionit- Propozoi krijimin e grupit punues që do të merret me modelin e Komisionerit të ardhshëm.

Të propozuar për këtë grup punues janë, Rexhep Selimi, Anton Quni dhe Fatmir Xhelili, ndërsa në konsultim të vazhdueshëm do të jenë me Kryetarin e Komisionit, gjithashtu ai tha se për këtë qëllim duhet të shikuar agjenda që në shator të formohet grupi i zgjeruar për përcaktimin e aktiviteteve të radhës.

Tutje tregoi rolin e grupit punues për hulumtimin për përfshirjen e segmenteve të sigurisë në kuadër të Komisionerit dhe në njërin nga mbledhjet e radhës të tregohen të gjeturat nëse një gjë është e mundur si dhe nga grupi punues mund të propozohet data për të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së, FSK-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe organizatat e tjera që merren me çështjet e sigurisë.

Në këtë pikë të rendit të ditës Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet Grupi punues për hartimin e bazës ligjore për Komisionerin e Sigurisë me këtë përbërje: Rexhep Selim-raportues, Fatmir Xhelili, Anton Quni, anëtarë.

Goran Marinkovič- Për pjesëmarrjen në grupin punues ai tha se nuk e konsideron të jetë pjesë e këtij grupi, pasi personat më me përvojë në këtë fushë mund të shërbejnë pozitivisht në këtë fushë.

Fatmir Xhelili- Për rolin e grupit punues që do të merret me hartimin e bazës ligjore dhe modelit për Komisionerin e ardhshëm ai tha se qëllimi kryesor i këtij grupi do të jetë konsultimi me zyrën ligjore të Policisë së Kosovës dhe të IPK-së, për të parë nëse baza ligjore aktuale me krijimin e institucionit të Komisionerit, a bien në kundërshtim me to dhe me Kodin e procedurës penale dhe me institucionet e tjera disiplinore në të cilat bëhen ankesa nga zyrtarët në rastet kur konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat dhe pas një konsultimi të tillë të dilet me propozime konkrete.

Kryetari i Komisionit- Për krijimin e grupit punues për institucionit të Komisionerit ai tha se pajtohem që grupi të vazhdoj të punoj tutje.

Pasi në rend të ditës u shtua edhe çështja e zjarreve për të cilën gjë z. Rasim Demiri ka qenë i angazhuar duke qene se vjen nga ky rajon dhe se ka qene në kontakt të vazhdueshëm ku dhe me Komandantin e FSK-së, Ministrin e FSK-së për situatën e zjarreve, fjalën ia kaloi z. Rasim Demiri.

Rasim Demiri- Për situatën e krijuar me zjarret ai tha se në çdo moment ka qenë në kontakt me z. Ahmet Isufi dhe z. Rexhep Selimi. Tutje ai tha se zjarret kanë ndodhur me 6 gusht në kufirin me Shqipëri në zonën e Koretnikut dhe se ka vazhduar në pjesën e Kosovës. Sipas tij sikur të ishin marrë masat me kohë, zjarret do të ishin evituar dhe se punëtorët e pylltarisë kanë punuar në këtë drejtim por kjo ka qenë e pa mjaftueshme për evitimin e zjarreve.

Komuna e Dragashit si një vend i varfër nuk ka qenë e gatshme dhe nuk ka treguar interesim për lokalizimin e zjarreve, gjithashtu ai tha se për këtë qëllim është kërkuar ndihmë nga KFOR-i gjerman të cilët nuk kanë poseduar balona për fikjen e zjarrit. Situata e krijuar ka bërë që në 200m vijë ajrore është afruar zjarri afër fshatit dhe se banoret janë detyruar ta lëshojnë fshatin.

Ndërsa Kryetari i Komunës së Dragashin nuk ka vizituar banorët dhe se më zjarret që janë bërë u është shkaktuar dëm i madh shtetit, për këtë qëllim është dashur që Komisioni nga Ministria për Bujqësi, Pylltari të bëjë vlerësimin e dëmeve , tutje ai falënderoi Komandantin e FSK-së për gatishmërinë për të ndihmuar dhe se për situatën e krijuar Kosova është dashur të kërkoj ndihmë nga ndonjë vend tjetër.

Fatmir Xhelili- Për situatën e zjarreve të krijuar ai tha se emergjencat dhe situatat e tilla diskutohen në opinion vetëm pasi të kenë ndodhur, ndërsa aktivitetet dhe planet që planifikohen para këtyre situatave nuk merren seriozisht nga disa pjesëtarë të disa institucioneve kompetente, për këtë arsye shtoi ai që si Komision duke e marrë në konsideratë situatën e krijuar të kërkojmë sigurimin e fondeve rezervë komunale për situata emergjente, pasi në nivel komunal nuk posedojnë fonde të tilla.

Për këtë qëllim ai propozoi që nga Komisioni të bëhet një propozim që të krijohen Komisione qoftë nga Ministria e Punëve të Brendshme ose edhe i përzier ku do të përfshiheshin pjesëtarët e FSK-së, për të bërë inspektimin e ekipeve zjarrfikësve komunal

për të bërë identifikimin e pajisjeve të vjetra që nuk janë funksionale dhe që të insistohej që ti përmbahen masave të parapara me plan të reagimit dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të merren masa për hapjen e rrugëve malore të parapara për situata emergjente, duke e shfrytëzuar FSK-në për një ndihmë të tillë.

Tutje ai shtoi se ekziston një marrëveshje me Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë për veprim të përbashkët në situata të tilla, gjithashtu u pajtua me propozimin e z. Rasim Demiri që mund të kërkohet ndihmë për helikopter uxor dhe konsideroi se Komisioni duhet të insistoj që institucionet ti përmbushin obligimet që u takojnë.

Rexhep Selimi- Për situatën e zjarreve ai tha se duhet të punohet në preventivë, duke i përgatitur institucionet lokale dhe qendrore për reagim kundër zjarrit si dhe për hapjen e rrugëve, pasi kjo merret si justifikim në rastet e mos reagimit. Tutje ai tha se Komisioni duhet ta vlerësoj gjendjen si të rëndë e cila është e fokusuar në zonën e Dragashit, Bjeshkët e Sharrit dhe rajonin e Gjilanit dhe vlerësoi se nga institucionet e Kosovës, FSK-së duhet ti jepet kapacitet më i madh për të reaguar.

Në vazhdim ai tha se një raport nga institucionet përkatëse për vatrat e zjarrit do të ishte i nevojshëm në Komision, në mënyrë që të dihen vatrat e zjarrit, masat e marra në mënyrë që Komisioni mund të dal me rekomandime. Tutje ai tha se Komisioni duhet ti bëjë kërkesë Njësive të hetimit të Policisë së Kosovës për identifikim e zjarrëvënies të qëllimshme, pasi ndodhin shpesh, dhe se sipas tij një vlerësim i përgjithshëm nga Komisioni i situatës së zjarreve që ka ndodhur në pyjet e Kosovës, duke dal më pas me rekomandime.

Kryetari i Komisionit- Për propozimin e dhënë, ai tha se duhet ti drejtohem Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili bën raporte të detajuar për situatat e tilla, për të gjitha rajonet dhe ku në bazë të raportit të bëhet vlerësimi.

Tutje ai tha se nëse konsiderojmë që komunat të kenë buxhet për situatat emergjente, për këtë çështje ai propozoi dërgimin e një kërkesë Ministrisë së Financave që të marrin parasysh kur të bëhet planifikimi buxhetor si dhe sugjerimin nga ana e Komisionit që nga komunat të krijohen fonde nga të hyrat vetanake.

Bazuar në pikën e tretët të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim, tha se në Komision kemi rënë dakord që Neni 9 pika 2 nga ky projektligj të fshihet dhe se për këtë gjë është pajtuar edhe z. Goran Marinkovič dhe se mbetet neni 9 pika 1. Fjalën ia kaloi z. Marinkovič.

Goran Marinkovič- Për projektligjin në fjalë ai tha se nuk janë pajtuar me tre amendamente dhe se vonesa ka ndodhur për shkak se nuk është paraqitur me kohë deklarimi i grupit 6+, dhe se nga mbledhja e sotme e Komisionit për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, është pajtuar për amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional.

Fatmir Xhelili- Për këtë çështje tha se Komisioni nga mbledhja e kaluar ka marrë vendim që neni 9.2 të fshihet dhe me këtë propozim u është drejtuar Kuvendit.

Kryetari i Komisionit- Falënderoi anëtarët për pjesëmarrjen në takim dhe me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi